



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority
Nr. i Prot./Br. Prot./Prot. No. 82524-11/12
Nr. i Eq./Br. Sl./No. Pj. 1/4
Datumi/Date: 24.12.2024
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

Nr.111/24
Prishtinë, më 24.12.2024

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 26, nenit 27, nenit 29, nenit 35, nenit 36 paragrafi 6 neni 39 si dhe neni 55 paragrafi 2 me nën paragrafin 2.4, i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, bazuar në kundërshtim/ kërkesën e parashtruar nga Bastri Mekolli Autorë i Librit Art Figurativ për klasën e VIII-të, kundër Drejtorive të Arsimit në Komunat; Ferizaj, Gjilan, Skenderaj, Pejë, Rahovec dhe Klinë. Komisioni pas shqyrtimit të Raportit të Sekretariatit, në mbledhjen e mbajtur me datën 24.12.2024 merr këtë:

KONKLUZION

Autoriteti gjatë shqyrtimit paraprak, konstaton se nuk ka kushte për fillimin e Procedurës Hetimore ndaj, Drejtorive të Arsimit në Komunat; Ferizaj, Gjilan, Skenderaj, Pejë, Rahovec dhe Klinë, sipas nenit 36 paragrafi 6 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

A r s y e t i m

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, me datën 19.09.2024, me Nr. Prot. 622/24-01/H, ka pranuar kundërshtim/kërkesën nga Basri Mekolli, Autorë i Librit Art Figurati për klasën e VIII-të, kundër Drejtorive të Arsimit.

Pretendimet e paraqitësit të iniciativës:

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, me datën 19.09.2024, me Nr. Prot. 622/24-01H, ka pranuar kundërshtim/ kërkesën nga Basri Mekolli adresa: Dervish Rozhaja 69 Prishtinë, me pretendimin se:

Libri shkollor, Art Figurativ për klasën e VIII-të, nga Shtëpia Botuese "Libri Shkollor" ka fituar në konkursin e MASHTI-it, si libri më i mirë nder konkurrentë i vlerësuar nga recensentët e caktuar nga MASHTI-i. Tashmë që tri vite manipulohet përzgjedhje e librit tim nga Drejtoret e Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA-të) në komunat e cekura më lart duke i dërguar në MASHT raportin e përzgjedhjes të librit, ku autor është Basri Mekolli, me zero përzgjedhje. Përkundër përzgjedhjes së tekstit shkollor nga arsimtarët dhe aktivet e lëndës Art Figurativ VIII të cilët e kanë përzgjedhur këtë libër! DKA-të i manipulojnë listat duke e eliminuar konkurrencën e këtij libri dhe e dërgojnë raportin në MASHT me dy librat e radhitur më dobët sesa libri i tij (autorit Mekolli)!

Provat i kam nga telefonatat dhe lajmërimet e arsimtarëve se librat të cilat i porosisin ata, DKA-të i shpërfillin kërkesat e tyre dhe në shtator ju sjellin krejt tjera libra përkundër përzgjedhjes së tyre! Disa dëshmi të arsimtarëve në përzgjedhjen e librave jua bashkëngjisë në e-mail, por

U.B

J.M.

SEL

që raportet e DKA-ve dërguar MASHT-it janë krejt tjera libra të shtëpive tjera botuese të cilat i favorizojnë vet DKA-të!

Efektet negative si pasojë e veprimeve të tilla janë: arsimimi-aftësimi i nxënësve dhe shoqërisë në përgjithësi në nivelin më të ultë, ngecjen e gjeneratave të tëra me ofrimin e librave jo-kompetentë dhe të renditura më dobët sesa libri më kualitativ dhe me kompetencë profesionale për nxënësit e kësaj moshe kalendarike dhe mentale.

Eliminimi nga konkurrenca, fyerja intelektuale dhe profesionale e imja nga zyrtarët e DKA-ve gjegjëse, si autorë i librit më të vlerësuar dhe libri më i mirë për nxënësit!

Sa i përket dëmit personal financiar duke marrë parasysh gjeneratën sipas MASHTI-it me numër prej 24,665 nxënës, dëmtimi im do të ishte diku mbi 15,000 €.

Dëmi i shtëpisë botuese duhet të jetë tri-katër herë më i madh. Shifrat mund të jenë edhe më të mëdha, sepse nuk i di shërbimet e shtypit dhe shërbimet tjera, si p.sh. distribuimi i teksteve, etj.!

Unë kam bërë ankesë edhe DKA-ve dhe në MASHT, por deri më tani nuk kam përgjigje, përveç që një zyrtare e MASHT-it më ka sugjerua të ju shkruaj edhe ju!

Pengesat në hyrje në treg të librit tim vijnë nga dy shtëpitë botuese konkurrenente, duke i blerë zyrtarët dhe disa zyrtarë në MASHTI, pasi që arsye tjetër nuk ka! Shtëpia Botuese "Libri Shkollor" prej nga përfaqësohem si autor i tyre, nuk e ka aplikuar këtë natyrë të ndytë si normë pune, prandaj gjendja që tri vjet është me këto statistika të dëmshme për të gjithë!

Paraqitësi i iniciativës ka kërkuar që, në zbatimin e dispozitave ligjore të Ligjit Nr.08/L-056. Për Mbrojtjen e Konkurrencës, të hetohet kjo formë e sjelljes së DKA-ve, ndaj autorëve/botueseve të librave shkollor.

Takimi me përfaqësuesit dhe Përshkrimi i Gjendjes Faktike të rastit

Me datën 26.09.2024, grupi punues ka zhvilluar takim me Autorin e Librit Art Figurativ për klasën e VIII, z.Basri Mekolli. Pretendimet e palës, gjatë takimit ishin se: Drejtorit e Arsimit në Komunitat e cekura më lartë nuk e përzgjedhin librin e tij, tash e 3 vite. Gjithnjë sipas tij, ky libër është përzgjedhur nga recensentët e caktuar nga MASHTI-i, si libri më i mirë ndëre konkurrentet. Sipas z. Mekolli, si autori i librit i takojnë vetëm 0.36 € për një libër. Por, DKA-të i plotësojnë formularët e kërkesave vet ne qytetet më numër më të madh të nxënësve (në komunitat e cekura më lartë)dhe, as një libër i tij, pretendon se nuk ka shkuar nëpër shkolla. Gjatë komunikimit me mesimdhënësit e shkollave, që ka pasur ankuesi të njëjtë kanë deklaruar se linku i Librit Art Figurativ për klasën e VIII, nuk është dërguar në shkolla, për arsye që të mos jetë i përzgjedhur nga mesimdhënësit.

TREGU PËRKATËS APO RELEVANT

Tregu gjeografik - duke iu referuar nenit 4, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për përcaktimin e tregut përkatës Nr. 01/2023, bazuar në analizën e këtij rasti, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Komunës së Ferizajt, Gjilanit, Skenderaj, Pejë, Rahovec dhe Klinë.

Tregu i produktit "Libri Shkollor Art Figurativ" për klasën e VIII-të.

Informata zyrtare nga MASHTI-it për katalogun e botimeve

Pas takimit me palën ankuese, janë marrë edhe konfirmimet zyrtare të procedurave të ndjekura nga ana e institucioneve përgjegjëse. Fillimisht duhet theksuar se, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, u ka dërguar të gjitha DKA-ve, katalogun e botimeve

zyrtare, nga të cilat do të mund të bëhet përzgjedhja për tekste shkollore për klasat 1-9 për vitin shkollor 2024/2025, si dhe linçet e teksteve fituese të shtëpia botuese për mësimdhënësit të cilët nëpërmjet linçeve mund t'i lexojnë tekstat dhe t'i përzgjedhin.

Afati i paraparë për të dorëzuar katalogun e plotësuar (në 4 kopje) ka qenë data 08.07.2024.

Dhe, bazuar në këtë, mund të theksojmë se katalogu përfshinë të gjitha botimet zyrtare të aprovuara nga ana e MASHTI-it.

Përgjigjet nga Drejtorit e Arsimit në Komunitet e cekura më larte

Autoriteti nga Drejtoritë e Arsimit të komunave të lartcekura, ka kërkuar informata shtesë, rreth përzgjedhjes së librave shkollor. Përgjigjet ishte se: procesi i përzgjedhjes së librave është zhvilluar sipas procedurës së paraparë nga MASHTI, të cilët kanë dërguar katalogun të DKA-të, të njëjtin ju është përcjellë shkollave, më pastaj është bërë përzgjedhja e teksteve shkollore nga stafi mësimor.

Analiza e Konkurrencës

Autoriteti i Konkurrencës, angazhohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës (Abuzimit me Pozitën Dominuese, Marrëveshjeve të Ndaluar, Praktikave të Bashkërenduara dhe Realizimit të Përqendrimeve të Paligjshme) nga ndërmarrjet ekonomike private apo publike, por edhe nga kufizimet e shkaktuara nga administrata shtetërore dhe entet rregullatore në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë saj, nëse këto veprime kanë efekte në Kosovë.

Parimi themelor i ligjit dhe politikës së konkurrencës është të sigurojë qasje në treg të lirë për çdo ndërmarrje, e cila i plotëson kushtet për të konkurruar në atë treg në interes të përdoruesve të shërbimeve dhe të mund të konkurrojnë me çmim dhe cilësi.

Objektivi kryesor i politikës së konkurrencës është ruajtja e procesit konkurrues dhe nxitja e konkurrencës efektive në treg. Ruajtja ose nxitja e konkurrencës efektive është e domosdoshme, duke pasur parasysh kufizimet që sektori privat apo ai shtetëror/publik mund t'i bëjnë konkurrencës. Prandaj ligji i konkurrencës ndalon marrëveshjet për fiksimin e çmimit, abuzimin me pozitë dominuese, si dhe përqendrimet që rrezikojnë të krijojnë një pozitë dominuese në treg.

Autoriteti konsideron se, në rastet kur ligjet e sektorit përkatës parashikojnë marrjen e masave të posaçme, si kontrolli i çmimeve ose aksesit në infrastrukture fizike, organet publike/rregullatorët sektoriale kanë detyrën dhe përgjegjësinë kryesore për të mbikëqyrur këta parametra të konkurrencës.

Gjithashtu, ligji formal që rregullon një sektor të caktuar duhet të parashikojë organin kompetent, të shprehë qartë që ky i fundit zotëron një kompetencë për caktimin ose miratimin e çmimeve, si dhe rastet në të cilat caktohet çmimi. Gjithashtu, përcaktohet se ky organ duhet të ushtrojë kompetencën, domethënë duhet të ketë marrë një vendim për rastin konkret.

Zhvillimi i ankandeve/tenderëve dhe formave tjera kontraktuale publike jep mundësi për transparencë dhe konkurrencë në procesin e përzgjedhjes, që lejon përdorimin efikas dhe efektiv të fondeve publike. Këto parime janë vendosur në shumicën e ligjeve moderne të prokurimit publik dhe duhet të sigurohen nga autoritetet kontraktore.

Autoriteti konsideron se sipas Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Para-universitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ të MASHTI-it Nr.08/2022 për Dokumentacionin Shkollor

U.P.B.

J.M. SGL

në Arsimin Para-universitar, si dhe vendimin nr.2-880, dt.11.05.2023 për caktimin e kushteve dhe kriterëve për botimin e dokumentacionit shkollor para-universitar. MASHT kishte pasur mundësi zgjedhje te kompanitë tjera, rrjedhimisht edhe autorë tjerë të cilët plotësojnë kriteret profesionale. Në këtë drejtim, edhe përcaktimi i librave shkollor që plotësojnë kriteret, është bërë bazuar në recesionet profesionale të cilat janë bërë nga ana e MASHT.

Autoriteti në rastin konkret, nuk është kompetent për zbatimin e ligjeve të veçanta, por aspekti ligjor dhe rregullativ është në kompetencë të institucioneve tjera ligjore, e në këtë rast Drejtorive të Arsimit në Komunat. Ndërsa për pretendimet tjera të cilat i pohon pala, që lidhen me kërkesat e mësimdhënësve të caktuar, se ajanë trajtuara apo jo nga ana e DKA-ve, bazuar në ligjin në fuqi, kjo nuk është pjesë e kompetencave që Autoriteti ka për ti trajtuar.

Nga sa më lartë, Komisioni i Autoritetit duke u bazuar në nenin 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, vendosi si në diapozitiv të këtij Konkluzioni.

Obligohet Sekretariati që të kujdeset për zbatimin e këtij konkluzioni.


Ky konkluzion, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana Komisionit.

AUTORITETI I KONKURRENCËS

Komisioni

Neime Binaku - Isufi


Kryetare



Kaltrina Sela
Nënkryetare



Nafije Osdautaj
Anëtar



Floren Mehmeti
Anëtare



Salihe Gashi Loku
Anëtare



Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa, por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative në afat prej 30 ditësh, nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.

Me këtë KONKLuzion të njoftohen:

- Paraqitësi i Iniciativës
- Publikohet në web faqen e Autoritetit
- Arkiva